

RREGULLORE
“PËR VEPRIMTARINË E KOMITETIT AD HOC
PËR ADMINISTRIMIN E PROCESIT TË EMËRIMEVE
NË KOLEGJIN E POSAÇËM TË APELIMIT”

Miratuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin nr. 11/1, datë 06.11.2017

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 69, pikës 4 të nenit 18, pikës 1,2 të nenit 22 dhe germës *dh* të nenit 21 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të pikës 2 të nenit 20 e pikës 2 të nenit 27 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, Mbledhja e Gjyqtarëve

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Plotësimi i vendeve vakante në personelin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit realizohet nëpërmjet një procedure të hapur dhe transparente, e cila rregullohet nga ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga “Kodi i punës” dhe nga rregullat e miratuara nga Mbledhja e Gjyqtarëve.
2. Kandidat për një pozicion pune është personi i cili plotëson kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, të përcaktuara nga ligji nr. 84/2016 dhe ato të publikuara në faqen zyrtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelit apo në publikimet e tjera të bëra prej këtij institucioni, sipas rastit.
3. Personat e përfshirë në të gjitha nivelet e administrimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve për t’u bërë pjesë e personelit, deklarojnë me shkrim që nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga pjesëmarrësit apo kandidatët në proces në kuptim të nenit 30 të “Kodit të procedurave administrative” dhe të ligjit “Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”.

II. SHPALLJA E VENDEVE VAKANTE

1. Për plotësimin e vendeve të lira në personelin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, bëhet shpallja në faqen zyrtare në internet të Kolegjit dhe të paktën në dy media me tirazhin më të lartë në vend, në faqen zyrtare *online* për punësimin, si edhe në çdo media *online* të mundshme për t’u realizuar sipas rastit. Afati minimal për dorëzimin e aplikimit dhe

dokumentacionit shoqërues është 10 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së vendit të lirë në një nga faqet në internet të përdorura për këtë qëllim.

2. Shpallja e vendeve të lira për këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë kryhet me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve, ndërsa për pozicionet e tjera të lira kryhet me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Komitetin *ad hoc*.
3. Shpallja do të përfshijë mundësisht edhe kategorinë/klasën e pagës.
4. Përfshihen nga kjo procedurë rekrutimi personat e personelit, pjesë e kabinetit të kryetarit, të cilët emërohen në zbatim të rregullave të përcaktuara në pikën 1 të nenit 17 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

III. FUNKSIONET E KOMITETIT AD HOC

1. Autoriteti përgjegjës për kryerjen e procesit të vlerësimit të kandidatëve për çdo pozicion pune, pjesë e personelit të institucionit, është Komiteti *ad hoc*.
2. Komiteti *ad hoc* krijohet në mënyrë të përhershme pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe përbëhet nga tre anëtarë, nga të cilët dy gjyqtarë të Kolegjit dhe një komisioner publik, të zgjedhur sipas rregullës së përcaktuar në nenin 18/4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
3. Komiteti *ad hoc* është organ kolegjal. Çdo anëtar i Komitetit vlerëson jetëshkrimin dhe dokumentet e kandidatëve, si dhe kryen vlerësimin e tyre gjatë intervistës me gojë në mënyrë individuale për çdo kandidat.
4. Komiteti *ad hoc* organizon mbledhjet e tij, duke dokumentuar çdo fazë të procesit në mënyrë më të përshtatshme, me qëllim që:
 - a. Të kryejë verifikimin paraprak për kandidatët që plotësojnë kriteret ligjore dhe ato të posaçme që janë shpallur për pozicionet e punës. Pas këtij procesi, vendos të skualifikojë kandidatët që nuk i plotësojnë këto kritere. Kandidatët që nuk plotësojnë kriteret njoftohen se janë skualifikuar, ndërsa të tjerët se vazhdojnë garën në një nga mënyrat që vendos Komiteti *ad hoc*, brenda një afati prej 10 ditësh nga dita e mbylljes së aplikimeve.
 - b. Të vendosë për kryerjen e testimit me shkrim për pozicione të caktuara pune, kur e sheh të arsyeshme, si dhe modalitetet e kryerjes së tij.
 - c. Të diskutojë dhe të bjerë dakord për pyetjet të cilat do t’u drejtohen kandidatëve në intervistën me gojë.
 - d. Të vlerësojë kandidatët duke u mbështetur në dokumentacionin e paraqitur prej tyre, në intervistën me gojë dhe në testimin me shkrim, kur vendoset që ai të kryhet.

IV. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR

1. Në procesin e përzgjedhjes së këshilltarëve ligjorë dhe ekonomikë, Komiteti *ad hoc*, pas kryerjes së verifikimit paraprak për plotësimin e kriterëve ligjorë dhe të intervistës me gojë të atyre që i kanë plotësuar kriteret, vlerëson kandidatët nëpërmjet përfshirjes së tyre në tri grupe, duke i vlerësuar “shumë mirë”, “mirë” dhe “pranueshëm”. Kandidatët e grupuar në këtë mënyrë i paraqiten Mbledhjes së Gjyqtarëve për përzgjedhjen në pozicionet e shpallura. Mbledhja e Gjyqtarëve vendos për çdo kandidat me shumicën e numrit të të gjithë anëtarëve.
2. Në grupin e vlerësuar “*shumë mirë*”, futen kandidatët që plotësojnë në mënyrë kumulative të paktën tri nga kriteret e mëposhtme.
 - a) Kanë kryer studimet e larta në universitete publike brenda vendit apo në universitete jashtë vendit.
 - b) Kanë mbrojtur grada shkencore apo kanë kryer botime në fusha të ndryshme të së drejtës.
 - c) Kanë njohuri të gjuhëve të huaja të tjera, përpos gjuhës angleze.
 - ç) Kanë eksperiencë pune mbi 10 vjet në sistemin e drejtësisë apo në administratën publike.
 - d) Kanë eksperiencë pune si ish-gjyqtarë, ish-prokurorë, ish-ndihmësgjyqtarë apo oficerë të policisë gjyqësore.
 - dh) Kanë eksperiencë pune në nivele drejtuese në administratën publike.
 - e) Kanë eksperiencë pune në drejtim të kërkimit e këshillimit ligjor, në fusha të ndryshme të së drejtës, si edhe në drejtim të hartimit të dokumenteve ligjore.
 - ë) Kanë eksperiencë pune si financierë në fushën e mbikëqyrjes bankare e financiare, në fushën kontabël, njohuri të mira në teknologjinë e informacionit apo në auditin shtetëror ose ndërkombëtar.
 - f) Marrin një vlerësim “kënaqshëm” nga Komiteti *ad hoc* në intervistën me gojë.
3. Në grupin e vlerësuar “*pranueshëm*” do të futen kandidatët që plotësojnë një nga kriteret e mëposhtme.
 - a) Kanë përfunduar studimet në universite private brenda vendit.
 - b) Kanë një mesatare note të studimeve të larta nën 7.
 - c) Kanë probabilitet të lartë për të pasur raste të konfliktit të interesit për shkak të lidhjeve me subjektet e rivlerësimit.
 - ç) Kanë eksperiencë pune të fundit në institucionet e konsideruara ndihmëse për organet e rivlerësimit, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit.
 - d) Rezulton se janë përfshirë në çështje të diskutuara rreth integritetit të tyre profesional dhe që mund të kenë cenuar besimin e publikut të këta individë.
 - dh) Marrin vlerësimin “mjaftueshëm” në intervistën me gojë.

4. Kandidatët që nuk bëjnë pjesë në asnjë nga dy grupet e mësipërme, do të futen në grupin tjetër që do të vlerësohet “*mirë*”. Në këtë grup do të përfshihen edhe kandidatët të cilët plotësojnë njëkohësisht kriteret për t’u përfshirë në të dyja grupet: “shumë mirë” dhe “pranueshëm”.
5. Mbledhja e Gjyqtarëve kryen përzgjedhjen e këshilltarëve ligjorë e ekonomikë, duke u mbështetur në vlerësimin e kryer nga Komiteti *ad hoc*.
6. Urdhri për emërimin në pozicionin e këshilltarit ligjor apo ekonomik, si edhe kontrata individuale e punës për ta, nënshkruhet nga Kryetari i Kolegjit dhe individi përkatës në zbatim të vendimit të marrë në Mbledhjen e Gjyqtarëve.
7. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës njoftohen për mënyrën e vendimarrjes nëpërmjet shpalljes së fituesve/të emëruarve në faqen zyrtare të Kolegjit/të Gjykatës Kushtetuese, brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

V. PERSONELI ADMINISTRATIV

1. Komiteti *ad hoc* vlerëson kandidatët që kanë aplikuar për vende vakante, duke u mbështetur në jetëshkrimin e tyre e dokumentet shoqëruese, testimin me shkrim, kur vendoset të kryhet, si edhe në intervistën me gojë.
2. Komiteti *ad hoc* harton listën e shkurtuar me kandidatët e renditur sipas vlerësimit të bërë në mënyrë kolegjiale dhe ia dorëzon këtë listë Sekretarit të Përgjithshëm. Lista e shkurtuar përmban si rregull tre kandidatët e përzgjedhur nga Komiteti *ad hoc*, duke përcaktuar edhe një renditje mes tyre. Në rastet kur ky numër nuk arrihet për shkak të pjesëmarrjes së ulët apo të mospërshtatshmërisë së kandidatëve, përzgjedhja bëhet mes atyre që konsiderohen të përshtatshëm sipas vlerësimit të Komitetit *ad hoc*.
3. Në rast se asnjë nga kandidatët nuk konsiderohet i përshtatshëm për pozicionin e shpallur, Komiteti *ad hoc* së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm vendosin të rishpallin vendet vakante.
4. Sekretari i Përgjithshëm përzgjedh për pozicionin e shpallur një nga kandidatët e listës së shkurtuar. Në rast të mosrespektimit të renditjes së bërë nga Komiteti *ad hoc*, Sekretari i Përgjithshëm jep me shkrim në një akt të motivuar arsyet e përzgjedhjes së kryer prej tij.
5. Urdhri për emërimin e punonjësit në administratën e Kolegjit dhe kontrata individuale e punës nënshkruhen nga Sekretari i Përgjithshëm dhe individi përkatës, në përfundim të procedurës së përshkruar më lart.

6. Të gjithë kandidatët njoftohen për mënyrën e vendimmarrjes nëpërmjet shpalljes së fituesve/të emëruarve në faqen zyrtare në internet të Kolegjit/Gjykatës Kushtetuese, brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i urdhrimit të emërimit.

VI. HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Mbledhja e Gjyqtarëve.